

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, bazuar në nenin 28 dhe nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga shoqëria ALPE GEF ZOB, shoqëri për investime, sh.p.k., me seli në rrugën Verovshkova 55A, 1000 Lubjanë, Slloveni, dorëzuar përmes Shoqërisë së Avokatëve Knezoviç dhe bashkëpunëtorët nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 27.11.2024, miratoi këtë

AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin ALPE GEF ZOB, shoqëri për investime, sh.p.k., me seli në rrugën Verovshkova 55A, 1000 Lubjanë, Slloveni do të fitojë kontrollin mbi OrtoDental, veprimtari stomatologjike dhe këshillim profesional sh.p.k., me seli në rrugën Vilharjeva 42, 1000 Lubjanë, Slloveni, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2.Parashtruesi i njoftimit për përqendrim detyrohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6,000.00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30,000.00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 10000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

A r s y e t i m

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 04.11.2024, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni)ka pranuar një njoftim për përqendrim nga ALPE GEF ZOB, shoqëri për investime, sh.p.k., me seli në rrugën Verovshkova 55A, 1000 Lubjanë, Slloveni, me të cilin ALPE GEF ZOB, shoqëri për investime, sh.p.k. do të fitojë kontrollin mbi OrtoDental, veprimtari stomatologjike dhe këshillim profesional sh.p.k., me seli në rrugën Vilharjeva 42, 1000 Lubjanë, Slloveni.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe bazuar në të dhënat e dorëzuara në Njoftimin për përqendrim dhe shtojcat e tij konstatoi si vijon:

Aktivitetet kryesore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

-ALPE GEF ZOB, shoqëri për investime, sh.p.k. është menaxheri më i madh i fondeve private të investimeve me seli në Slloveni. Ajo menaxhon 2 fonde private investimi: ALFI PE sh.p.k., SIS k.d. dhe ALFI PE Grout SIS sh.p.k. k.d. Parashtruesi është në pronësi 100% të ALFI PE GEF GP sh.p.k & ALFI PE Grout SIS sh.p.k. k.d.

Veprimtaria e regjistruar e ALPE GEF ZOB, shoqëri për investime, sh.p.k. është aktivitetet e menaxhimit të fondeve.

-Grupi ALFI aktualisht ka 1 shoqëri të lidhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut: Shoqëria për tregti dhe shërbime APOLLO MK SHPKNJ Shkup, me seli në bul. Kiro Gligorov nr. 13 Shkup dhe me veprimtari prioritare - tregtia me shumicë e mallrave të tjera shtëpiake. Shoqëria kryesisht merret me shitjen e lodrave, pajisjeve dhe tekstilit. Shoqëria është e pranishme në treg edhe përmes dyqanit të saj online. Gjithashtu, shoqëria kryen edhe veprimtari ndihmëse (non-core) të furnizimit dhe instalimit të sistemeve të alarmit për operatorët celularë që përfshin një përqindje të vogël të shitjeve.

-OrtoDental veprimtari stomatologjike dhe këshillim profesional sh.p.k. është një qendër stomatologjike që ofron shërbime dhe procedura të ndryshme stomatologjike, e specializuar për proteza të padukshme Invisalign dhe implantologji. Veprimtaria e regjistruar e Shoqërisë së Synuar është veprimtaria e ordinancës stomatologjike.

OrtoDental veprimtari stomatologjike dhe këshillim profesional sh.p.k. nuk ka subjekte të lidhura të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, as nuk ka realizuar qarkullim në vitin 2023 në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi që i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit dhe pikën 6 c) i) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin pasi që nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij vendimi mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të tij.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

KRYETARE

Ана Николоска